



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2658/ 1 prot.,

Datë 27.08.2026

**FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “E.B.S” sh.p.k, në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me nr. REF-88723-06-03-2026, me objekt “Studim i Fizibilitetit për Projektin “Përmirësimi dhe Zhvillimi i Sistemit të Menaxhimit të Ujërave të Shiut në Qytetin e Vlorës” me fond limit 25,000,000 (njetete e pesemilion) lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 21-07-2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

Ankimues: Operatori ekonomik “E.B.S”sh.p.k, me Nipt K72014002P, dhe adresë: Rruga " Teodor Keko", pallati "ALES Konstruksion", shkalla nr.1, kati 7-të.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Vlorë
Adresë: Sheshi 4 heronjtë, Bashkia Vlorë.

Në datën 26.08.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr. aplikimi A/2026/7203, dhe nr. 2658/2026 prot., datë 26.08.2026 e operatorit ekonomik “E.B.S” sh.p.k, në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me nr. REF-88723-06-03-2026, me objekt “Studim i Fizibilitetit për Projektin “Përmirësimi dhe Zhvillimi i Sistemit të Menaxhimit të Ujërave të Shiut në Qytetin e Vlorës” me fond limit 25,000,000 (njetete e pesemilion) lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 21-07-2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “E.B.S” sh.p.k.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërmat “b” dhe “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimues “E.B.S” sh.p.k kundërshton me anë të ankesës më poshtë vijon:

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime se operatori ekonomik “E.B.S” sh.p.k, nuk përmbush kërkesat/kriteret si më poshtë:

- *Nuk plotesohen kriteret e meposhteme: 2.3.5 Operatori ekonomik ofertues në përlllogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshitllit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”. Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet te jete brenda kufijve te vleres minimale dhe maksimale te lejuar ne kuptim te nenit 7/1 te VKM nr 354, datë 11.05.2016”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim.*

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 27.08. 2026

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Edvin Simo

Anëtar
Donika Daci

Anëtar
Nertil Kanina

Nënkryetar
Gjergj Mersini

Kryetar
Ismail Shehu